



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 dhjetor 2024
Nr. Ref.:RK 2591/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin KI51/24

Parashtrues

Isa Salihi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit, P.M.L. nr. 63/2024,
të 6 shkurtit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhami Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Isa Salihi, avokat nga Prishtina (në tekstin e mëtejshmë: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kérkesës konteston Aktvendimin [P.M.L. nr. 63/2024] e 6 shkurtit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktvendimin [PN. nr. 4/2024] e 11 janarit 2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit), si dhe Aktvendimin [PKR. nr. 323/2017] e 22 dhjetorit 2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të kontestuara të gjykatave të rregullta, përmes të cilave pretendohet se parashtruesit të kérkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kérkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kérkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 23 shkurt 2024, parashtruesi i kérkesës përmes postës dorëzoi kérkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata). Kërkesa e parashtruesit të kérkesës është regjistruar në Gjykatë më 26 shkurt 2024.
6. Më 8 mars 2024, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimeve [GJR.KI51/24] dhe [KSH.KI51/24] caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtyues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhami Rexhepi (anëtarë).
7. Më 25 mars 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kérkesës për regjistrimin e kérkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Supreme.
8. Më 30. tetor 2024, Kolegji shqyrtyues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kérkesës.

Përbledhja e faktave

9. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kérkesës është avokat i cili ka përfaqësuar të akuzuarin G.A. pranë Gjykatës Themelore në procedurën penale [PKR. nr. 323/2017].
10. Më 21 dhjetor 2023, Gjykata Themelore caktoi dhe mbajti seancën e shqyrimit lidhur me rastin penal [PKR. nr. 323/2017], ku morën pjesë Prokurorja e Shtetit si dhe i akuzuari G.A., me parashtruesin e kérkesës si mbrojtësin e tij. Gjatë seancës së

shqyrtimit fillestar, avokati i të dëmtuarit A.Sh në procedurën penale, deklaroi se “[...] një avokat (duke iu referuar parashtruesit të kërkesës) *nuk mund të përfaqësojë dy palë kur pala e dëmtuar* eshtë e njëjtë”. Me këtë rast, Gjykata Themelore kërkoi që për këtë çështje të deklarohet edhe Prokurori i Shtetit.

11. Lidhur me këtë çështje, Prokurori i Shtetit para Gjykatës Themelore *inter alia* deklaroi:

[...] kur kanë filluar të urdhërohen masat e fshehta nga Gjykata për rrith 16 të dyshuar më vonë të akuzuar, për shkak të volumit dhe numrit të madh të dyshuarve lënda eshtë ndarë në 4 pjesë, dhe pasi eshtë ndarë secili prej prokurorëve ka bërë aktvendim për fillim të hetimeve ndaras, e në të cilën çështje janë të përfshirë të pandehurit G.A. dhe personi A.Sh. në rastin PKR. nr. 757/2016, të cilët i përfqëson av. Isa Salihu (parashtruesi i kërkesës), [...] pavarësisht procedurave gjyqësore të ndara që janë duke u zhvilluar, kemi të bëjmë me një rast të njëjtë penal...”.

12. Më 22 dhjetor 2023, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [PKR. nr. 323/2017] përmes të cilit refuzoi parashtruesin e kërkesës si mbrojtës të pandehurit G.A., në procedurën penale sipas Aktakuzës [PP/I. nr. 812/2015] të 13 tetorit 2017.

13. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Themelore theksoi:

“dispozita e nenit 54 par. 1 të KPPRK-së përcakton se: “1. Në një procedurë penale mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, pavarësisht se a eshtë bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me të njëjtën çështje penale dhe me të njëtin të dëmtuar, ku ndalohet që një mbrojtës në një situatë të tillë të përfaqësojë dy të pandehur.”

14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [PKR. nr. 323/2017] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se, *“Gjykata Themelore ka vërtetuar gabimisht pretendimin e paraqitur nga përfaqësuesja e palës së i dëmtuar [A.Sh.], e cila ka cekë se një avokat nuk mund të përfaqësoj dy të pandehur kur pala e dëmtuar eshtë e njëjtë”*.
15. Më 11 janar 2024, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PN. nr. 4/2024] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktvendimin [PKR. nr. 323/2017] e Gjykatës Themelore.
16. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit theksohet:

“Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në aktvendimin e ankimuar, Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeshmëri të drejtë [...] dispozita e nenit 54 par. 1 të KPPRK-së përcakton se: “1. Në një procedurë penale mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, pavarësisht se a eshtë bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës”.

*Gjykata e Apelit rikujton se kjo dispozitë ligjore eshtë në thelb në funksion të mbrojtjes efektive pa u dëmtuar cilido i pandehur në përfaqësim nga dhënia e ndihmës juridike profesionale, duke qenë se çështjet penale shpesh herë ndërlidhen ndërmjet subjekteve aktive si të bashkëpandehur e rrjedhimisht në mbrojtje efektive ka rëndësi të veçantë bashkëpunimi i mbrojtësit me të pandehurin që e përfqëson, ky bashkëpunim shpërfaq edhe aspekt të konfidencës ndërmjet mbrojtësit dhe të pandehurit, rrjedhimisht kjo normë parandalon gfarëdo **pasiviteti në mbrojtjen efektive** e njëkohësisht duke pamundësuar që një mbrojtës të përfaqësoj më shumë se një të*

pandehur pavarësishët procedurës penale të bashkuar apo të veçuar, kjo e bënë të pandehurin më të pacenueshëm dhe me siguri më të lartë juridike pa mëdyshje në bashkëpunimin e ndërtimit të strategjisë së mbrojtjes”.

17. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktvendimit [PKR. nr. 323/2017] të Gjykatës Themelore dhe Aktvendimit [PN. nr. 4/2024] të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë pér mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykaten Supreme, pa i deklaruar bazat ligjore, por me propozimin që “*Gjykata Supreme ta aprovojë kërkesën dhe vendimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje*”.
18. Më 6 shkurt 2024, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PML. nr. 63/2024] e hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën pér mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
19. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi:

“Sipas dispozitës së nenit 432 par. 1 të KPP kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë në rast të shkeljes së ligjit penal, në rast të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 i këtij kodit ose në rast të shkeljeve tjera të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërisë mund të paraqitet, gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin, vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

Në rastin konkret bëhet fjalë pér vendim me të cilin është refuzuar përfaqësimi i avokatit në një çështje penale, i cili vendim është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dyte, pra, vendimet kundër të cilave është paraqitur kërkesa nuk janë vendime me të cilat ka përfunduar procedura penale, e nuk kanë të bëjnë as me çështjen e paraburgimit, prandaj kjo gjykatë vlerëson se kërkesa është e papranueshme”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktvendimeve të gjykatave të rregullta i janë shkelur të drejtat e tij, të garantuara me nenet 31 [E Drejta pér Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta pér Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta pér një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta pér zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

Pretendimet pér shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

21. Përkitazi me pretendimet pér shkelje të së drejtës pér gjykim të drejtë dhe të paanshëm, parashtruesi i kërkesës thekson se, *“Është parim fundamental i drejtësisë dhe i së drejtës së garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, që çështja të gjykohet drejtë dhe në afat të arsyeshëm. Ky parim dhe obligim kushtetues dhe ligjor është shkelur rëndë fillimisht me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, më pastaj Gjykatës së Apelit dhe së fundi me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas dispozitave ligjore të ligjeve të aplikuar në Republikën e Kosovës, çështjen e përfaqësimit – mbrojtjen efikase të palëve në procedurë penale nga Neni 52 i KPPRK-së. E drejta e të pandehurit pér të pasur mbrojtës: 1. I dyshuarit dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale. 2. Para çdo marrjeje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia ose organi tjetër kompetent, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjyques ose*

kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshtuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe që mbrojtësi mund të jetë prezent gjatë marrjes së tij në pyetje”.

22. Për më tepër, parashtruesi i kérkesës pretendon se Gjykata e Apelit, duke mos ndryshuar dispozitivin e aktvendimit të shkallës së parë, ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe se gjykata e shkallës së dytë nuk ka marrë fare parasysh shkeljet procedurale dhe materiale të cilat i ka bërë shkalla e parë në dëm të parashtruesit të kérkesës, por vetëm e refuzon ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit si të pabazuar dhe vërteton aktvendimin e shkallës së parë.
23. Parashtruesi i kérkesës gjithashtu shton se, “*edhe Gjykata Supreme shkeli të drejtën për gjykim të drejtë, sepse ai përmes kérkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kishte kérkuar që Gjykata Supreme të konstatojë se Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë fare gabimisht ka shqyrtuar dispozitat ligjore nga neni 54 të KPPRK-së, gjë që ajo nuk e bëri. Ajo e hudh si të pa pranueshme kérkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe në asnje paragraf nuk i ka shqyrtuar pretendimet e parashtruesit të kérkesës...”.*
24. Në mbështetje të shkeljes së nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], parashtruesi i kérkesës në një paragraf pretendon se, “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*”.
25. Gjithashtu, parashtruesi i kérkesës edhe shkeljen e pretenduar të nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave) e shpjegon me një deklaratë se, “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejtë të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjetet efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
26. Parashtruesi i kérkesës kérkon nga Gjykata të shpallë se kérkesa është e pranueshme, të konstatojë se Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PML. nr. 63/2024] të 6 shkurtit 2024, shkeli të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të drejtën për mjetet efektive juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [PML. nr. 63/2021] e Gjykatës Supreme të Kosovës të 6 shkurtit 2024.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Dispozitat përkatëse të Kushtetutës

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Neni 32
[E Drejta pér Mjete Juridike]

Secili person ka tē drejtē tē përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative tē cilat cenojnë tē drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54
[Mbrojtja Gjyqësore e tē Drejtave]

“Cdokush gëzon tē drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast tē shkeljes ose mohimit tē ndonjë tē drejte tē garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe tē drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Konventa Evropiane pér tē Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta pér një proces tē rregullt)

“1. Çdo person ka tē drejtë që çështja e tij tē dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati tē arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do tē vendosë si pér mosmarrëveshjet në lidhje me tē drejtat dhe detyrimet e tij tē natyrës civile, ashtu edhe pér bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim tē tij. Vendimi duhet tē jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese tē tij, në interes tē moralit, tē rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e tē miturve ose mbrojtja e jetës private tē palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana tē veçanta publiciteti do tē dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

3. Çdo i akuzuar pér një vepër penale ka tē drejtat minimale tē mëposhtme:

[...]

c) tē mbrohet vetë ose tē ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në goftë se ai nuk ka mjete tē mjaftueshme pér tē shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë.

[...].

Neni 13
(E drejta pér zgjidhje efektive)

“Cdokush, tē cilit i janë shkelur tē drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka tē drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përm bushje tē funksioneve tē tyre zyrtare”.

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

KAPITULLI V

MBROJTËSI

Neni 52
E drejta e tē pandehurit pér tē pasur mbrojtës

- “Idyshuari dhe i pandehuri kanë të drejtë të kenë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale”.
[...]

Neni 54 **Kufizimet në përfaqësim nga mbrojtësi**

- “Në një procedurë penale mbrojtësi nuk mund të mbrojë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje, pavarësisht se a është bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës. Një mbrojtës nuk mund të përfaqësoj personin juridik dhe personin fizik në të njëjtin rast, përveç nëse personi fizik është i vetmi person që ka në pronësi, menaxhon dhe është i punësuar nga personi juridik.
- I pandehuri mund të ketë deri në tre (3) mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është përbushur kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit.

[...]"

C. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Neni 432 **Arsyet për paraqitje së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë**

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

- 1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;
- 1.2. në rast të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafit 1 i këtij Kodi; ose
- 1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tillë kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

[...]"

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

- Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
- Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113 [Juridiksi dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".
[...]"*
29. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tej në Ligj, përkatësisht në nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që parashikojnë:
- Neni 47
(Kërkesa individuale)
- "1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*
- Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)
- "Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".*
- Neni 49
(Afatet)
- "Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...".*
30. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [P.M.L. nr. 63/2024] e 6 shkurtit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës; pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
31. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretnisht, paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton që:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".

32. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GJEDNJ-së *Kemmachev kundër Francës*, aplikimi nr. [17621/91](#), kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, aplikimi nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, aplikimi nr. [4241/03](#), kategoria (iii)), (shih rastet e Gjykatës, KI04/21, parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26; dhe [KI175/20](#), parashtruese *Ajencja Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
33. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
34. Gjykata rikuhton se parashtruesi i kërkesës është avokat i cili në një fazë të procedurës penale e përfaqëson si mbrojtës të akuzuarin G.A, në çështjen penale sipas Aktakuzës [PP/I. nr. 812/2015] të 13 tetorit 2017. Përmes Aktvendimit të Gjykatës Themelore, atij i ishte pamundësuar përfaqësimi i të akuzuarit G.A duke konstatuar se, “*përfaqësimi i tij i mëtejshëm i personit G.A është në kundërshtim me nenin 54, paragrin 1 të KPPRK-së*”. Gjykata konstaton se edhe Gjykata e Apelit në procedurën ankimore i ka mbështetur konkluzionet e Gjykatës Themelore si të drejta dhe të bazuara në dispozitën përkatëse ligjore. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, ku kjo e fundit të njëjtën e hudhi poshtë si të palejueshme.
35. Prandaj, Gjykata, rikuhton se parashtrues i kërkesës është avokati, të cilit në procedurë penale i është pamundësuar përfaqësimi apo mbrojtja e të akuzuarit G.A.. Parashtruesi i kërkesës, pretendon se në rastin konkret të akuzuarit i janë shkelur e drejta për zgjedhje të mbrojtësit në procedurë penale, dhe në këtë kuptim ai pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, përderisa në lidhje me të, ai pretendon se i janë shkelur të drejta për mjete juridike dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave, të garantuara me nenet 32 dhe 54, respektivisht.
36. Në lidhje me të lartcekurat, Gjykata vë në dukje se në kërkesën KI11/24 ka trajtuar çështjen e të drejtës për të zgjedhur mbrojtësin në procedurë penale, e drejtë kjo e garantuar me paragrin 5 të nenit 30 të Kushtetutës, në ndërlidhje me pikën c) të paragrafit 3 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Megjithatë, ndryshe nga rrëthanat e rastit konkret, parashtrues në kërkesën KI11/24 ishte i pandehuri, të cilit i ishte refuzuar mbrojtja sipas zgjedhjes së tij, për shkak se gjykata e rregullta kishin konstatuar se dy të pandehur në çështjen e njëjtë penale nuk kanë të drejtë të kenë mbrojtësin e njëjtë, ashtu siç përcaktohet në paragrin 1 të nenit 54 të KPPK-së.
37. Duke iu rikthyer rrëthanave të rastit konkret, Gjykata thekson se nuk do t'i vlerësojë të lëshohet në pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me shkeljen e të drejtës për të zgjedhur, për shkak se i akuzuari G.A. nuk është parashtrues para

Gjykatës. Në këtë kuptim, Gjykata marrë për bazë procedurën e zhvilluar para gjykatave të rregullta, përkatësisht para Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit si dhe pretendimet e ngitura në kërkesë që ndërlidhen drejtpërdrejtë me parashtruesin e kërkesës në cilësinë e palës së autorizuar, në thelb i referohen të drejtave të tij të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka arsyetuar dhe ofruar asnjë argument në lidhje me shkeljen e të drejtës, të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i vlerësojë pretendimet e tij të ngitura në kërkesën e tij në kontekst të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të drejtës së tij përvendim të arsyetuar, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

38. Në ndërlidhje me pretendimet e tij, të ngitura në kontekst të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e që i referohen arsyetimit të gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se pretendimet e tij ndërlidhen me interpretimin e dispozitave ligjore nga ana e gjykatave të rregullta. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës specifikon se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit kanë vepruar “*në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe gjykata e shkallës së dytë fare nuk është marrur me shkeljet procedurale dhe materiale të cilat i ka bërë shkalla e parë*”.
39. Në lidhje me të lartcekurat, në kuptim të parimit të subsidiaritetit dhe doktrinës së shkallës së katërt, Gjykata vazhdimesht ka theksuar dallimin në mes të “*kushtetutshmërisë*” dhe “*ligjshmërisë*” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përvëç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose KEDNJ (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI96/21](#), parashtrues [Xhelal Zherka](#), Aktvendim për papranueshmëri i 23 shtatorit 2021, paragrafi 49; [KI145/20](#), parashtruese [Belgjyzar Latifi](#), Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68). Si rrjedhojë, roli i Gjykatës Kushtetuese është të përcaktojë nëse efektet e interpretimit të gjykatave të rregullta janë në përputhje me normat dhe standarde kushtetuese dhe të konstatojë nëse zbatimi i ligjit ka rezultuar me përfundime arbitrale që kanë rezultuar me cenimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara me Kushtetutë.
40. Gjykata, pas shqyrtimit të gjendjes faktike të rastit konkret, shkresave të lëndës, si dhe aktvendimeve të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, vëren se qëndron fakti i parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit i kanë bazuar përfundimet e tyre për pamundësinë e tij për të mbrojtur një person të caktuar në procedurën gjyqësore në nenin 54 paragrafin 1 të KPPK-së. Megjithatë, duke shqyrtuar më konkretisht arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore, Gjykata konstaton se vendimi, të cilin Gjykata Themelore e bazoi në nenin 54 paragrafin 1 të KPPK-së, nuk është nxjerrë vetëm në bazë të kërkesës së mbrojtësit të palës së dëmtuar në procedurën penale, i cili kërkoi nga Gjykata Themelore të vërtetojë, “*a mundet një mbrojtës i njëjtë të përfaqësojë dy palë kur pala e dëmtuar është e njëjtë*”, por edhe në bazë të arsyetimit të detajuar të prokurorit, të cilit i është kerkuar nga Gjykata Themelore të sqarojë në mënyrë të hollësishme lidhjet ndërmjet shkakut dhe pasojës dhe thelbin e rasteve të referuara nga mbrojtësi i palës së paditur, si dhe korrelacionin e parashtruesit të kërkesës në të dyja çështjet penale në të cilat ai paraqitet si mbrojtës i të pandehurve.
41. Pikërisht në mbështetje të kësaj, Gjykata vëren se prokurori kompetent ka ofruar arsyetime të cilat kanë mjaftuar për Gjykatën Themelore t'i referohet nenit 54, paragrafit 1 të KPP-së, duke konstatuar se përkundër faktit se këtu kemi dy procedura

gjyqësore të pavarura dhe të veçuara, “*kemi të bëjmë me një rast të njëjtë penal, e që dispozita e nenit 54 par. 1 të KPPRK-së, përcakton se: “1. Në një procedurë penale nuk mund të mbrojë dy apo më tepër të pandehur në të njëjtën çështje penale, pavarësisht se a është bërë veçimi i procedurës apo fazës së procedurës”*. Prandaj, Gjykata Themelore konkludoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me një çështje të njëjtë penale dhe me të njëtin të dëmtuar, në të cilën ndalohet që një mbrojtës në një situatë të tillë t'i përfaqësojë dy të pandehur, duke përm bushur kështu kushtet për zbatimin e kufizimeve të nenit 54 paragrafit 1 të KPP-së.

42. Gjykata, në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, konsideron se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës pranë gjykatave të rregulla, megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetveti të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, kërkesa nr. 5503/02](#), Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
43. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjafsheshme pretendimin e tij se gjykatat e rregullta mund të kenë zbatuar dispozitën e lartpërmendur të KPP-së në mënyrë të gabuar, dhe rrjedhimisht pretendimet e tij për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm, kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “*ligjshmërisë*” dhe nuk janë argumentuar në nivel të “*kushtetutshmërisë*”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
44. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e ndërlidhë shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, duke konsideruar se Gjykata Supreme në kontekst të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nuk e ka trajtuar çështjen e zbatimit të gabuar të paragrafit 1 të nenit 54 të KPPK-së. Megjithatë, Gjykata rikujton se kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruar në Gjykatën Supreme ishte hudhur poshtë si e palejueshme për shkak se nuk kishte plotësuar kushtet e parapara me paragrin 1 të nenit 432 të KPPK-së.
45. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së e që ndërlidhen me Aktvendimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë pretendime që kualifikohen si pretendime të kategorisë (ii) që karakterizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”. Për pasojë, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet përmes paragrafit (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Pretendimet për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së

46. Për sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e arsyeton këtë shkelje me pretendimin se “*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj, që është në pajtim me nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së*”.
47. Në mbështetje të kësaj, Gjykata thekson se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se GJEDNJ në praktikën e saj ka përcaktuar parimet dhe kriteret në lidhje me të drejtën për mjete efektive juridike, të garantuar me nenin 13 të KEDNJ-së. Për më tepër,

Gjykata rikujton se edhe Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se neni 32 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, garanton qasjen në mjete juridike për të adresuar pretendimet për shkeljen e të drejtave dhe lirive, në çfarëdo forme që ato mund të kenë ndodhur (shih, rastet e Gjykatës [K186/18](#), me parashtruese *Slavica Đorđević*, Aktgjykim i 3 shkurtit 2021, paragrafël 124-125; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së [*Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*](#), nr. 9659/82, 9658 /82, Aktgjykim i 27 prillit 1988, parografi 52).

48. Gjykata gjithashtu rikujton se neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike] i Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, garanton të drejtën për të përdorur mjet juridik kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat e garantuara në mënyrën e përcaktuar me ligj; (i) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë është shkelur; dhe (ii) të drejtën për një zgjidhje efektive nëse është shkelur një e drejtë e garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ (shih, në mënyrë analoge, rastin e GJEDNJ-së *Boyle Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 27 prillit 1998, parografi 52). Në vijim, Gjykata duke iu referuar qëndrimit të GJEDNJ-së vëren se kjo e fundit ka vënë në pah se neni 13 duhet të jetë “efektiv” si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih, rastin e GJEDNJ-së *Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykim i 27 qershorit 2000) dhe se “efektiviteti i mjetit juridik”, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, nuk është i kushtëzuar me garancinë për një zgjidhje të favorshme për parashtruesin e kërkesës (shih, rastin e GJEDNJ-së *Kudla kundër Polonisë*, nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, parografi 157).
49. Në kuptim, të procedurës së ndjekur, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në procedurën e mbrojtjes së të drejtave të tij, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, duke përdorur kështu mjetin juridik të përcaktuar me ligj. Megjithatë, sa i përket mjetit juridik, atij të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur në Gjykatën Supreme, Gjykata thekson se neni 432, paragrafi 1 i KPPK-së, përcakton qartë se kur mund të përdoret ky mjet juridik, përkatësisht cilat janë vendimet gjyqësore dhe shkeljet ndaj të cilave mund të përdoret. Për pasojë, Gjykata thekson se vetë fakti se parashtruesi i kërkesës nuk i ka përbushur kushtet formale për paraqitjen e këtij mjeti juridik nuk e bën këtë mjet, si jo-efektiv.
50. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhen me shkelje të të drejtave të tij, të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së janë hyjnë në kategorinë e pretendimeve të kategorisë që karakterizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”, dhe si të tillë duhet të shpallen të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30.tetor 2024, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari rapportues

Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani